



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 282/<sub>2</sub> prot.

Tiranë më 09. 4 .2020

V E N D I M

Nr. 09 , datë 09. 4 .2020

PËR

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1858/2 prot, datë 26.12.2019, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi *World Vision Albania* tek marrësi *World Vision USA* në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues, *World Vision Albania* ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”) pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi *World Vision USA* i vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit, për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

(i) Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Jeta profesionale;
- Numri i sigurimit shoqëror;
- Formimi – Diplomat – Medaljet;
- Adresa (karakteristikat e banesës);
- Foto;
- Video të përfituesve të programit;

- Raca dhe etnia;
- Shëndeti;
- Gjendja gjyqësore (dënimet penale).

(ii) Shteti ku do të realizohet transferimi: *Shtetet e Bashkuara të Amerikës.*

(iii) Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë:

- Nëpunës;
- Punëmarrës;
- Furnizues;
- Fëmijë të moshës 3 deri në 18 vjeç, pjesë e programit të sponsorizimit.

(iv) Frekuenca e Transferimit është: *Periodikisht.*

(v) Qëllimi i transferimit, citojmë: *“Të dhënat personale të fëmijëve pjesë / përfitues të programit të sponsorizimit, transferohen në filialin e World Vision USA me qëllim gjetjen e sponsorëve dhe ngritjen e fondeve që mbështesin programin e zhvillimit të World Vision Albania. Të dhënat personale të fëmijëve përpunohen dhe transferohen vetëm për qëllime të programit, për të krijuar mundësi zhvillimi për fëmijët më në nevojë, vetëm për ata fëmijë, për të cilët prindërit / kujdestarët e tyre ligjorë kanë dhënë pëlqimin me shkrim për mbledhjen, përpunimin dhe transferimin e të dhënave personale të fëmijëve.*

*Të dhënat personale të punonjësve transferohen me qëllim ruajtjen dhe përpunimin e tyre në formë digjitale, për qëllime të menaxhimit të forcës punëtore.*

*Të dhënat personale të furnizueve transferohen me qëllim ruajtjen dhe përpunimin e tyre në formë digjitale, për qëllime të menaxhimit të informacionit mbi tregun, bizneset dhe forca blerëse të organizatave si dhe parashikimit të buxheteve për investim në të ardhmen”.*

(vi) Ndërkohë në rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “Rrethanat lidhur me përpunimin” subjekti transferues ka deklaruar: *“Sipas klauzolave të listuara në lejen e prindit/kujdestarit ligjor, vetëm pas marrjes së lejes me shkrim nga ana e tyre, bëhet regjistrimi i fëmijëve në programin e sponsorizimit të World Vision Albania. ... Siç specifikohet në lejen e prindit, këto të dhëna mbledhen dhe përpunohen vetëm për qëllime të programeve të zhvillimit... Në asnjë rrethanë, të dhënat nuk bëhen publike pa autorizimin e subjektit të përpunimit të të dhënave, në këtë rast prindi/kujdestari ligjor i fëmijëve.*

*Në lidhje me punonjësit, procesi vijon vetëm pas dakordësisë me shkrim të punonjësit.*

*Përsa i takon kategorisë Furnitorët, gjatë procesit të ftesës për bashkëpunim me ta, çdo subjekt prezantohet dhe informohet me natyrën e të dhënave dhe qëllimin e përpunimit, procesi vijon vetëm pas dakordësisë me shkrim të tyre në formularin e regjistrimit të bisnesit”.*

(vii) Në lidhje me rubrikën 8, natyra e përpunimit dhe kohëzgjatja e tij, citojmë: *“Të dhënat përpunohen vetëm për t'i vendosur ato në funksion të interesit më të lartë të fëmijës. Të dhënat që lidhen me shëndetin, edukimin dhe nivelin e jetesës, përdoren për të gjetur një donator, i cili mbështet programet e zhvillimit të World Vision Albania... Të dhënat personale të subjektit të të dhënave përpunohen dhe transferohen, për aq kohë sa e lejon kujdestari ligjor i fëmijës... Nga momenti i largimit nga programi të subjektit të përpunimit të të dhënave, World Vision Albania ndalon përpunimin dhe transferimin e të dhënave personale të subjektit”.*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Të dhënat personale ruhen elektronikisht në databazën e sigurt të World Vision USA, të aksesueshëm vetëm nga një numër i kufizuar i stafit të autorizuar. Këto të dhëna mbeten, edhe pse inaktive, në sistem, jo më shumë se 3 vite pas largimit të subjektit të përpunimit të të dhënave nga programi. Pas 3 viteve në status inaktiv, sistemi i eliminon këto të dhëna automatikisht”.*

Në bazë të Vendimit nr. 8, datë 31.10.2016, të Komisionerit *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk përfshihen në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte, në zbatim të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, subjekti kontrollues *World Vision Albania* është i detyruar të kryejë transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri në lidhje me ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim, subjekti përveç Formularit të Aplikimit, ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Dokumentin *“Formë miratimi i prindit/kujdestarit për përfshirjen e fëmijës në projektin e letërkëmbimit”*;
- Dokumentin *“Deklaratë Burimeve Njerëzore mbi Informacionin e Privatësisë”*;
- Formularin e Aplikimit për Autorizimin e transferimit në një shtet pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale;
- Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale;
- Marrëveshjen për transferimin e të dhënave lidhur ndërmjet World Vision Albania dhe World Vision USA.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimit të përmbajtjes së tyre rezulton se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për *“Lejimin e disa kategorive të*



*transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.*

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi World Vision Albania plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit germës “b” dhe “c” të pikës 2 të nenit 8, pikës 2 të nenit 9 dhe nenit 26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar

### **V E N D O S A:**

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi World Vision Albania, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi World Vision Albania lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave World Vision USA e vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale *“fëmijë të moshës 3 deri në 18 vjeç”, “punëmarrës” dhe “furnizues”, të dhënat, si më poshtë:*

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
  - Numri personal i identifikimit;
  - Jeta profesionale;
  - Numri i sigurimit shoqëror;
  - Formimi – Diplomat – Medaljet;
  - Adresa (karakteristikat e banesës);
  - Foto;
  - Video të përfituesve të programit;
  - Raca dhe etnia;
  - Shëndeti;
  - Gjendja gjyqësore (dënimet penale).
2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, të paraqitur pranë Komisionerit, i cili ka të bëjë me *“gjetjen e sponsorëve dhe ngritjen e fondeve që mbështesin programin e zhvillimit të World Vision Albania”, “ruajtjen dhe përpunimin e tyre në formë digjitale, për qëllime të menaxhimit të forcës punëtore”.*

3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1) nuk do të ruhen për asnjë moment më shumë se 3 vite pas largimit të subjektit të përpunimit të të dhënave nga programi (sipas parashikimit në marrëveshje).
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 03.04.2020

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

